



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.03.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 20 mars – 07 prill 2017.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë-Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”. ***(Komision për dhënie mendimi)***
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”. ***(Komision për dhënie mendimi)***
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”. ***(Komision për dhënie mendimi)***
5. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”. ***(Komision përgjegjës)***

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Luan Rama, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Edmond Leka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Tom Doshi, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Bashkim Fino, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Nard Ndoka.

Të ftuar:

Thimio Plaku - drejtor i Përgjithshëm i Politikave në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Jeta Dashi - këshilltare për Marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Liljana Mekollari - përfaqësues nga sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor

Ketrin Abazaj - specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Fondeve të Huaja në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Isa Memia - specialist në Sektorin e Politikave të Trajtimit të Mbetjeve të Ngurta Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Elona Mistrovica - përfaqësuese Ministria e Financave

Artan Hoxha- ekspert

Henrik Ligori- ekspert

Arben Rakipi-ekspert

Korajlka Bumci- përfaqësues i EURALIUS-it

Jon Smibert -ekspert OPDAT

Katrin Treska - drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Edlira Bako - drejtore e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (prokurore)

Denisa Hasko- inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (prokurore)

Bledar Dervishaj – përfaqësues nga Kabineti i Ministrit të Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Ju kërkoj ndjesë për fillimin me vonesë të kësaj mbledhjeje komisioni. Për shkak se në të njëjtën ditë shqyrtohen njëkohësisht marrëveshjet që janë në kalendarin e së enjtes dhe ngarkesa që kanë të gjitha komisionet sot u krijua ky problem lidhur me kohën e fillimit të mbledhjes.

Në rendin e ditës pika e parë është është kalendari i punimeve të komisionit.

A keni ndonjë sugjerim?

Dakord.

Pika e dytë është projektligji “Për miratimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë- Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për aeroportin ndërkombëtar të Tiranës””.

Janë të ftuar zoti Thimio Plaku dhe kolegët e ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Fillimisht një përmbledhje të shkurtër të projektit dhe pastaj vazhdojmë me pyetje dhe diskutime.

Thimio Plaku- Projekti i rehabilitimit të hekurudhës Durrës – Tiranë dhe lidhja e re me aeroportin e Rinasit është një nga projektet më të rëndësishme të ministrisë, për të mos thënë që është investimi më i rëndësishëm, që bëhet në hekurudhën shqiptare në një periudhë prej 30 vjetësh.

Është një projekt që ka filluar me projektet e nevojshme të fizibilitetit, me projektin e detajuar, të finalizuar së fundi me marrjen e një granti në samitin Parisit në vitin e kaluar prej 36,5 milionë eurosh për rehabilitimin e kësaj hekurudhe dhe ndërtimin e linjës së re me aeroportin e Rinasit, si dhe me marrjen e një kredie prej 36,4 milionë eurosh nga BERZH-i, i cili njëkohësisht do të jetë edhe koordinatori i grantit edhe i kredisë. Në total projekti kap koston prej 91,5 milionë eurosh, duke parashikuar këtu edhe kontributin e qeverisë shqiptare për tvsh- në dhe koston lokale.

Rëndësia e këtij projekti është e padiskutueshme për hekurudhën shqiptare, sepse investohet pikërisht në zemrën e kësaj hekurudhe, që është linja Tiranë- Durrës dhe, për më tepër krijon një lidhje intermodale me aeroportin Rinasit, duke ndërtuar një degëzim të ri

hekurudhor që nga Qafa e Kasharit deri në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit, në të cilin do të ndërtohet një terminal intermodal, i cili do të krijojë lidhjen ndërmjet transporteve tokësore, hekurudhore dhe ajrore. Pas këtij projekti do të ketë një zhvillim tjetër që do të jetë rivendosja e stacionit të trenit në pozicionin ku ka qenë, duke u integruar me bulevardin e ri të Tiranës. Pra stacioni i dikurshëm i trenit që kishte transport pasagjerësh dhe transport mallrash tashmë do të vendoset si një stacion terminal vetëm për pasagjerët pikërisht pas parkingut nëntokësor që është ndërtuar në hyrje të bulevardit të ri në distancën rreth 100-200 metra dhe do të bëjë lidhjen e aeroportit të Rinasit me qytetin Tiranës.

Fatmir Xhafaj - Po, relatori!

Edmond Leka – Sipas kalendarit, komisioni ynë sot është për shprehje mendimi për ratifikimin e marrëveshjes për rikonstruksionin e hekurudhës Tiranë- Durrës, por edhe ndërtimin e linjës së re Tiranë-Rinas. Ky projektligj është i propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huas mes Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it për financimin e të dyja këtyre projekteve, si për rehabilitimin e hekurudhës Tiranë- Durrës, por, edhe për ndërtimin linjës së re Tiranë-Rinas.

Nëpërmjet këtij projektligji sigurohet një financim prej 36,8 milionë eurosh. Ndërtimi i kësaj linje të re ka si qëllim zhvillimin e transportit më të mirë në linjën Tiranë- Durrës, por edhe zhvillimin dhe ndërtimin e linjës së re Tiranë – Rinas, për të garantuar lëvizjen dhe ndërveprimin më të mirë të qytetarëve.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave si organi kompetent, sipas përcaktimit të nenit 81 të Kushtetutës. Kjo marrëveshje bazohet po në Kushtetutën e Shqipërisë, kreu II, “Për marrëveshjet ndërkombëtare”.

Si komision shikoj se është e bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe i propozoj komisionit për ta kaluar në seancë plenare.

Fatmir Xhafaj- Po faleminderit!

A ka pyetje?

A ka diskutime?

Luan Rama – Nuk kam as pyetje, as diskutim, zoti kryetar, por, nëse më lejon të bëj një objeksion, duke besuar se realisht ky investim do të realizohet dhe të mos ketë fatin e marrëveshjes së bërë gati 12-13 vjet më parë me Generell Motor’s, që, gjithashtu kishte në fokus trenin elektrik Tiranë- Durrës dhe që do të lidhte Tiranën me aeroportin e Rinasit. Shpresoj të mos ketë të njëjtin fat edhe ky projekt!

Fatmir Xhafaj –Faleminderit, zoti Rama!

Thimio Plaku - Ne nuk shikojmë asnjë pengesë, çdo gjë është gati, marrëveshjet janë firmosur nga ministri i Financave, paketa e investimit është e gatshme, pritet vetëm miratimi me ligj i kësaj pakete financiare dhe është e gatshme të fillojë. Do të doja të thosha që kushtet e atëhershme ishin disi ndryshe, megjithatë e kuptojmë interesimin e zotit Rama dhe premtojmë se nuk do të mbetet në mes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Rama – Dakord. Nuk kam arsye të dyshoj në seriozitetin e marrëveshjeve të nënshkruara, sepse përgjithësisht serioziteti në nënshkrimin marrëveshjeve nuk ka munguar asnjëherë, por meqenëse ju jeni optimist, a mund të na thoni kur parashikohet të përfundojë kryerja e këtij investimi?

Thimio Plaku - Investimi përfundon për një periudhë 2-3-vjeçare. Fillimi i punimeve do të bëhet ose seleksionimi i firmës, pritja e firmës ndërtuese e kompanisë ndërtuese dhe fillimi i punimeve pritset nga shtatori i këtij viti.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Plaku, në relacionin që shoqëron këtë marrëveshje ju thoni se ky është një ndër tri projektet fituese të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria këtë projekt ka fituar? Të tri projektet janë tonat apo janë të Ballkanit Perëndimor?

Thimio Plaku – Në Ballkanin Perëndimor konkurruan të 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor për të tri projektet. Prej të gjitha projektet që u aplikuan ne aplikuan vetëm për këtë projekt, me të cilin fituan tri vende Shqipëria, Kosova dhe Serbia. Projekti ynë ishte në të njëjtin madhësi me atë të projektit Serb, edhe ai po në fushën e hekurudhave.

Vasilika Hysi – Po terminali i transportit publik të Tiranës, terminali i ri, a do të jetë pjesë e këtij projekti apo është një projekt më vete?

Thimio Plaku – Terminali i transportit publik të Tiranës është pjesë e këtij projekti. Fillimisht ishte parashikuar që linja e rehabilitimit të bëhej deri në këtë terminal, të krijohej një stacion hekurudhor në këtë terminal, por, meqenëse ishte eliminuar linja hekurudhore deri në stacionin e trenit të Tiranës pikërisht për këtë më vonë do të ketë një shtesë të vogël projekti pikërisht për rivendosjen e linjës nga kryqëzimi i Kamzës deri në stacionin e ri të trenit që do të bëhet i integruar me bulevardin ri.

Luan Rama- A e parashikon ministria ose Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave projekte të tjera që e shtrijnë investimin edhe në linja të tjera hekurudhore, sepse çfarë vlere kanë në fund të fundit krijimi vetëm i një ishulli Tiranë-Durrës dhe Rinas, nëse nuk shkon zgjerimi i investimit edhe në linja të tjera të transportit hekurudhor, referuar edhe asaj që

thatë ju se Bashkimi Europian e ka prioritet investimin e transportit hekurudhor, për arsye të të gjitha lehtësirave dhe benefiteve që krijon ky lloj transporti. Pra, a ka një vijimësi projektesh më tej, për shembull Durrës- Lezhë- Shkodër, Durrës Vlorë-, Durrës Pogradec për t'u lidhur me Malin e Zi, për të vënë linjën lidhjes me Malin e Zi që është vjedhur një pjesë e hekurudhës, një pjesë tjetër është shkatërruar e të tjera?

Thimio Plaku - Absolutisht, po. Mund t'ju informoj që pikërisht javën e kaluar filloi studimi i fizibilitetit për hekurudhën Durrës -Rrogozhinë, Elbasan- Librazhd- Pogradec dhe Lin, pra lidhja me Maqedoninë, pas përfundimit të të cilit do të merret edhe vendimet përkatëse për investimet e nevojshme në këtë linjë hekurudhore. Problemi këtu nuk është pjesa jonë, kjo është pjesë e Korridorit 8, problemet qëndrojnë në territorin maqedonas, sepse aty që nga Kërçova në Strugë ose në Liqenin e Ohrit ka një mungesë linje hekurudhore për rreth 60 kilometrash, dhe për shkak të faktit që investimi që kërkohet për të ndërtuar këtë linjë të re është i konsiderueshëm, mbi 500 milionë euro, kjo shikohet si një handicap kryesor i krijimit të korridorit hekurudhor Shqipëri- Maqedoni dhe Bullgari duke dalë në Detin e Zi. Gjithashtu, kemi po me një grant prej 4,5 milionë euro të miratuar së fundi për të kryer projektin i zbatimit të hekurudhës Vorë-Hani i Hotit që është dega e dytë më e rëndësishme e hekurudhës sonë, sepse është linja e vetme ndërkombëtare që kemi si hekurudhë.

Pas kryerjes së këtij projekti do të aplikojmë, gjithashtu, për marrjen e fondeve të nevojshme për rehabilitimin tashmë të këtij seksioni hekurudhor për ekonominë e vendit tonë dhe hekurudhën.

Po kështu kemi edhe një projekt zhvillimi që shpresojmë të realizohet një studim, kemi aplikuar së bashku me ministrinë greke të Transportit për një studim fizibiliteti për linjën hekurudhore të Shqipërisë me Greqinë, për të cilin rreth muajit prill mendojmë të kemi përgjigjen përfundimtare një investim prej 1 milionë euro, një projektstudim fizibiliteti për linjën hekurudhore Pogradec- Kapshticë- Follorinë.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Neni 1? Dakord.

Neni 2? Dakord.

Miratohet edhe në tërësi.

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.03.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Luan Rama, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Edmond Leka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Tom Doshi, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Bashkim Fino, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Nard Ndoka.

Të ftuar:

Thimio Plaku - drejtor i Përgjithshëm i Politikave në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Jeta Dashi - këshilltare për Marrëdhëniet me Parlamentin në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Liljana Mekollari - përfaqësues nga sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor

Ketrin Abazaj - specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Fondeve të Huaja në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Isa Memia - specialist në Sektorin e Politikave të Trajtimit të Mbetjeve të Ngurta Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Elona Mistrovica - përfaqësuese Ministria e Financave

Vazhdojmë me projektin tjetër që ka lidhje me ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, 2013, 2014, për projektin program për menaxhim e mbetjeve”, dhe projektligji tjetër “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nën ministrinë tuaj, Po, dakord. Jemi në rregull.

Meqenëse të dyja janë me të njëjtin qëllim, a mund t'i përmbledhni në një parashtrim?

Thimio Plaku – Ashtu siç thatë edhe ju, është një paketë financimi, por e ndarë në dy marrëveshje të veçanta për shkak të natyrës së tyre. Njëra është ndërmjet qeverisë Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim financiar për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”. Është një kredi me kushte mjaft të favorshme nga qeveria gjermane në vlerën prej 12 milionë eurosh. Ka një shumë financimi grant prej 2 milionë eurosh për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit, janë zakonisht financime që jepen për njësinë e menaxhimit dhe të implementimit të projektit. Është dhe një tjetër shumë financimi në grant prej 500 mijë eurosh për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Marrëveshja tjetër është marrëveshja për bashkëpunim financiar të vitit 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve, faza e II”, ku akordohet një grant nga qeveria gjermane në vlerën prej rreth 7,5 milionë eurosh.

Projekti “Sistemi i menexhamit të integruar të mbetjeve në Vlorë” konsiston në ngritjen e infrastrukturës së duhur për trajtimin e mbetjeve, mbledhjen, transportin, asgjësimin sipas standardeve të BE-së. Studimi i fizibilitetit të këtij projekti është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët European për Ballkanin Perëndimor në kuadër të investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Po jap disa të dhëna për investimin. Nëpërmjet tij do të ndërtohet një sistem modern i menaxhimit të integruar të mbetjeve, i cili do të garantojë mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore, reduktimin e gazrave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë e zonës, do të rritet sasia e mbetjeve të ricikluara dhe të kompostuara, si edhe do të minimizohet depozitimi pa kriter i mbetjeve.

Pas zbatimit të reformës territoriale dhe administrative zonat e projektit të nisur fillimisht, përbëhen nga dy bashki, nga e ajo e Vlorës dhe e Selenicës. Investimi do t'i shërbejë një zone prej rreth 200 mijë banorësh. Me zbatimin e këtij projekti zgjidhet përfundimisht menaxhimi i integruar i mbetjeve të gjithë qarkut Vlorë, pasi për bashkitë e tjera si Sarandë, Himarë, Delvinë dhe Konispol është ndërtuar tashmë *landfill*-i i Bakajt në Sarandë, i cili shërben për trajtimin e mbetjeve të këtyre bashkive.

Ky projekt do të rrisë sasinë e mbetjeve të ricikuara dhe të kompostuara, do të reduktojë rrënjësisht shkarkimet nga depozitimi i mbetjeve, do të mbrojë qendrat e banuara dhe zonat turistike, po ashtu edhe abitatet e çmuara nga hedhja e mbeturinave nga kalimtarët dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve dhe do të reduktojë në minimum çlirimin e gazrave serë nga mbetjet. *Landfill*-i do të ndërtohet në Selishtë të Vlorës me një kapacitet prej rreth 350 mijë tonësh. Pjesë e investimit do të jetë ndërtimi i sistemit të mbetjeve të gazrave, impianti i trajtimit të ujërave të ndotura nga mbetjet, impianti i ndarjes së mbetjeve të riciklueshme me kapacitet 60 mijë tonë në vit. Kapacitet kompostimi për mbetjet organike deri në 4200 ton në vit. Mund të themi se është parashikuar në perspektivë zgjerimi i kapacitetit deri në 1 milion tonë, pra nga 350 mijë ton mund të shkojë deri në 1 milionë ton.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Agalliu.

Anila Agalliu - Faleminderit, zoti kryetar!

Për të dyja marrëveshjet ne jemi komision për dhënie mendimi. Objektivi i tyre, i këtij programi është dhënia e kontributit për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta ndërmjet investimeve në infrastrukturë të mbetjeve të ngurta dhe mbështetje institucionale për dhënien e një shërbimi të përmirësuar në pjesën e veriore të rajonit të Vlorës. Ratifikimi i kësaj marrëveshje qeveritare kushtëzon hyrjen në fuqi të marrëveshjes

së financimit ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave për rakordimin e grantit me qëllim zbatimin më tej të programit “ Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, rajoni i Vlorës”. Duke qenë se të dyja marrëveshjet janë në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, i propozoj anëtarëve të komisionit t’i miratojmë dhe t’i kalojmë në seancë plenare. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Atëherë me marrëveshjen e parë për bashkëpunimin financiar të viteve 2011, 2013, 2014 për këtë program, ka pyetje? Diskutime?

Piro Lutaj - Na ka marrë frika nga termi “menaxhimi i mbetjeve”. Nuk shikojmë përcaktimin e terminologjisë. Çfarë keni parasysh kur thuhet “menaxhimin e mbetjeve”? Për çfarë mbetjesh bëhet fjalë?

Fatmir Xhafaj - Besoj se për mbetjet e ngurta.

Thimio Plaku – Mbetjet shtëpiake, mbetjet urbane të bashkive Vlorë dhe Selenicë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ka diskutime? Nuk ka. Jeni dakord në parim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet.

Faleminderit!

Për marrëveshjen tjetër për bashkëpunimin financiar të vitit 2016, ka pyetje, diskutime? Nuk ka, besoj se u ezauruan.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.03.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Luan Rama, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Edmond Leka, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Tom Doshi, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Bashkim Fino, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Nard Ndoka.

Të ftuar:

Artan Hoxha – ekspert

Henrik Ligori- ekspert

Arben Rakipi- ekspert

Korajlka Bumci, - përfaqësuese e EURALIUS-it

Jon Smibert,- përfaqësues i OPDAT-it

Katrin Treska - drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Edlira Bako - drejtoreshë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë

Denisa Hasko - inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë

Bledar Dervishaj- përfaqësues i kabinetit të ministrit të Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”.

I kemi thënë besoj të gjitha fjalët e mira, vlerësimet që kemi pasur për ekspertët vendas, ata ndërkombëtarë, të ministrisë së Drejtësisë, relatorët për gjithë këtë punë të madhe që është bërë. **Tani do të vazhdojmë ta shqyrtojmë dhe miratojmë nen për nen.** Natyrisht, nëse do të ketë ndonjë gjë që ka shumë diskutim, do të japim edhe mundësinë edhe për ndonjë nen të veçantë, nëse do të ketë të tillë, që ta shikojmë në vazhdim në mënyrë që ky projekt të mbyllet nesër.

Neni 1. Kush është dakord? Ka vërejtje apo sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj -Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Besoj se po i ndjekin edhe përfaqësuesit e ministrisë, edhe ekspertët apo jo?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi- Kam një pyetje, te neni 8, paragrafi i pestë bëhet fjalë për gjykimin e të miturve, ndërkohë që kemi edhe Kodin e Drejtësisë për të mitur. Pyetjen e kam për

ekspertët: parashikimi i ndryshimit që bëni në pikën 4, a është në përputhje me Kodin e Drejtësisë për të miturit?

Fatmir Xhafaj – Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse të krijuara sipas ligjit. Do të referohet te ligji.

Vasilika Hysi -Këtu i referohet ligjit “Për organizmin e pushtetit gjyqësor”, por ka lidhje edhe me Kodin për Drejtësinë për të miturit.

Fatmir Xhafaj – Po, si do të themi këtu? Sipas Kodit të Drejtësisë pret ë mitur?

Ulsi Manja – Gjatë diskutimeve është parë e udhës të jetë ky formulim sipas ligjit që nënkupton edhe Kodin e Drejtësisë për të mitur.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se edhe zonja Hysi do të ketë rast ta shikojë më me kujdes në nenet në vijim. Nëse ka diçka, kemi mundësinë të gjithë që ta reflektojmë edhe kur ta përmbyllim.

Fatmir Xhafaj - Neni 9. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord?

Miratohet.

Që të mos çuditeni ju të medias, me gjithë respektin që kam për ju, këto nene janë debatuar, janë diskutuar nga ekspert disa herë jashtë këtyre tavolinave, së bashku me relatorët për t’i dhënë mundësi komisionit për të ecur sot shpejt. Jeni dakord edhe ju? Në rregull. Thjesht bëra në sqarim në vëmendjen dhe në respektin tuaj.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 16. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I njëjti grup është që ka punuar dhe më atë dhe me këtë.

Neni 23. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 24. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 25. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 26. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 27. Kush është dakord?

Vasilika Hysi - Te neni 27 bëhet fjalë për ndihmën juridike, ndërkohë në komision është depozituar edhe ligj “Për ndihmën juridike”.

Ju kërkoj ndjesë, meqenëse zoti Majko nuk është, jam e detyruar ta mbroj unë këtë pjesë. Në konsultimin që ka bërë zoti Majko si relator me ekspertët, por edhe me këshilltarët që mbulojnë ligjin “Për ndihmën juridike” konstatojnë se ka një mospërputhje dhe ka nevojë të përafrohet riformulimi i pikës 1 të nenit 27, i cili ndryshon nenin 34, germën “d”. Në germën “d” të projektit thuhet që personi nën hetim, ose personi i pandehur ka të drejtë të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës. Sipas parashikimeve të këtij kodi, sugjerohet të shtohet “edhe legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike”.

Neni 27, i cili ndryshon nenin 34, ku thuhet” pas nenit 34 shtohet neni 34, germa “a” si më poshtë, ku janë të drejtat e të pandehurit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te germa “d” thuhet: “Të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtje sipas parashikimeve të këtij kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike”. Në ligjin “Për ndihmën juridike” do të ketë disa parashikime të detajuara lidhur me kriteret e tjera. Pra, është vetëm kjo shtesë.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – Mund të shtohet: “Edhe sipas legjislacionit në fuqi”, por pa shtuar ato specifikimet pas, sepse ato mund të kenë edhe rregullime të tjera ligjore, të cilat mund të aplikohen, si edhe e përfshin shqetësimin që ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi - E kam nga pikëpamja e teknikës legjislative. Në një vlerësim që i është bërë veprimtarisë së komisioneve parlamentare, është quajtur si një mangësi lënia kaq e hapur e referimit, pa thënë se për cilin ligj dhe cilën fushë. Na është bërë vërejtje, prandaj jemi përpjekur në rishikimin e gjithë paketës së ligjeve që kemi në dorë, të bëjmë riformulim, për të thënë tek ligji specifik është ligji për ndihmën juridike.

Artan Hoxha – Tani një sqarim, nëse është e mundur. E para, ne nuk e dimë se çfarë thotë ai projektligj. E dyta, ky është kod, dhe kodi nuk referon akte më të ulëta, në raport me nivelin që ka vetë kodi. Por, duke thënë: “sipas legjislacionit në fuqi” nuk ka asnjë lloj gabimi, sepse mbrojtjen në procesin penal, të detyrueshme ose kur kërkohet dhe është rasti kur duhet t’i përcaktohet, në thelb e ka Kodi i Procedurës Penale. Mekanizmat se si realizohen, përsëri i ka Kodi i Procedurës Penale, por nëse ka edhe elemente të tjera, që parashikohen nga legjislacioni i posaçëm, ne i kemi të hapur, ndërkohë ligjet mund të ndryshojnë emra, ligjet ndryshojnë kohë. Akoma nuk e dimë se cili është ai rregullimi, sepse në dijeninë time, për shembull, është që ndihma juridike, sipas këtij ligji, nuk është për fushën penale. Çfarë është futur, e kemi futur ne në Kodin e Procedurës Penale. Vetë projektligji nuk parashikon ndihmën në procesin penal.

Tani, po t’i referohemi në mënyrë kaq eksplicite, e para, ky është një ligj më i lartë në hierarki. E dyta, nesër lëvizja e legjislacionit do të na kërkonte të ndryshonim Kodin e Procedurës Penale, dhe do të duheshin 84 vota. Kështu që, është edhe e arsyeshme, edhe e logjikshme, edhe në teknikë legjislative, që referimi i ndryshëm në ligj, sepse ky është ligj pothuajse ezaures, në legjislacion tjetër është më se i mjaftueshëm dhe nuk krijon rrisqe, që

nesër të detyrohesh t'i referohesh një legjislacioni, i cili mund të mos jetë, apo mund të ketë një rregullim të ndryshëm.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Besoj se me këtë sqarim, neni 26 dakord.

Neni 27. Dakord.

Neni 28. Dakord.

Neni 29. Dakord.

Neni 30. Dakord.

Neni 31. Dakord.

Neni 32. Dakord.

Neni 33. Dakord.

Neni 34.

A po i ndiqni ju, zoti Hoxha, zonja Bumçi? Dakord? Dakord. Në rregull.

Neni 34. Dakord.

Neni 35. Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, mbrojtje e detyrueshme.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me mbrojtjen e detyrueshme, ka pasur një diskutim se si do ta zgjedhë mbrojtësin organi procedues. Ideja është se, duke pasur parasysh përvojën e hasur deri më sot, në praktikë, sipas së cilës shpesh një prokuror ose gjyqtar lidhet me një mbrojtës konkret, vetëm me një person, pra duke mos respektuar kriteret, grupi i punës që ka punuar për ligjin “Për ndihmën juridike”, por bazuar edhe në shumë vërejtje e sugjerime të ardhura nga përfaqësues të shoqërisë civile që ofrojnë mbrojtje, sugjerojnë që organi procedues duhet ta zgjedhë mbrojtësin nga lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike, listë që duhet vënë në dispozicion nga autoritetet që administrojnë ndihmën juridike sipas legjislacionit në fuqi.

Pra, kërkojnë të ketë një specifikim, sipas të cilit nuk mund të merret çdo avokat që rri pas dëre, që nuk e studion fare dosjen, që bën një mbrojtje fiktive, formale, që hyn aty sa për të marrë një pagesë. Duhet të shtohet e organi procedues siguron menjëherë një mbrojtës të paguar, në bazë të listës së avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike, të vënë në dispozicion nga autoritetet që administrojnë ndihmën juridike sipas legjislacionit në fuqi.

Në këtë mënyrë, te ligji “Për ndihmën juridike” do të përcaktohen kriteret se si mund të përfshihet një avokat në këtë listë.

Pra, zoti Hoxha, ideja është të hiqet dorë përfundimisht nga avokatë që nuk kanë kualifikimet e specializimet e duhura, që nuk e studiojnë dosjen dhe nuk i mbrojnë realisht të drejtat e personit.

Nga ana tjetër, është hedhur edhe një ide. Ndoshta ju mund të jeni në dijeni. Meqenëse është në diskutim edhe ligji “Për avokatin në Republikën e Shqipërisë”, do të ishte mirë që edhe avokatët me përvojë të kishin mbrojtje për bono. Pra, nuk mund të vazhdojmë gjithmonë, që njerëzit e varfër, pabarazia për shkak të pozitës së tyre social-ekonomike, t’i bëjë të pabarabartë në proceset penale civile apo administrative.

Ky është një nga diskutimet e bëra në të dyja grupet e punës, që unë do të doja t’ua bëja prezent në këtë diskutim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po. Urdhëro, zoti Hoxha!

Artan Hoxha – Duke qenë plotësisht dakord me konstatimet e zonjës deputete, ne mendojmë se pika 37 e projektit ezauron faktin se mbrojtësit caktohen nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë, si dhe nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, sipas paragrafit 7. Pastaj, mënyra se si këta vijnë në këtë listë, nuk mendoj se është çështje e Kodit të Procedurës Penale, por është çështje e atij ligji organik, që rregullon mënyrën se si funksionon përcaktimi i rregullave se si bëhen mbrojtjet *pro bono*. Mund të jenë cilët do, mund të jenë avokatë të shquar, shumë të mirë, jo thjesht ata që rrinë pas derës, por nuk mendoj se është çështje e rregullimit të kësaj dispozite, e cila është ezauruese me paragrafet 3 dhe 7 të tij.

Vasilika Hysi – Kisha edhe diçka tjetër. Një nga çështjet e tjera të diskutuara, është: mbrojtësin do ta caktojë prokurori, apo ai do të zgjidhet nga vetë i pandehuri? Për të shmangur pikërisht këtë shqetësim, që ne na ka rezultuar, por që madje edhe është vënë në dukje në shumë raporte të organizatave monitoruese, që monitorojnë sistemin e drejtësisë, grupi i punës sugjeron se mbrojtësin duhet ta zgjedhë vetë i pandehuri. Pra, sugjerohet ë në pikën 2 të këtij neni të shtohet shprehja: “i zgjedhur vetë nga i pandehuri”.

Lidhur me shpjegimin që dhatë për riformulimin e pikës 7, unë jam dakord, sepse në draftin që unë kisha, pika 7 ishte fshirë. Bie dakord me argumentet që ju dhatë më parë.

Pra, çështja është: mbrojtësin do ta caktojë prokurori, gjykata, kë të duan ata, me të cilët mund të bëjnë edhe kompromise e mund të kenë lidhje klienteliste, apo do ta zgjedhë vetë i pandehuri nga një listë, sipas kritereve që duhet t’i detajojmë shumë mirë në ligjin për ndihmën juridike.

Artan Hoxha – Tani, Kodi i Procedurës Penale ka tri kategori mbrojtësish: mbrojtësin e zgjedhur nga i pandehuri, që është ai mbrojtës, tek i cili i pandehuri ka besim dhe e paguan, ose mund ta bëjë edhe *pro bono*, s’ka rëndësi; mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët, dhe kjo është për të pandehurin e arrestuar ose që është duke vuajtur një dënim me burg, arsye për të cilën nuk ka mundësi ta zgjedhë mbrojtësin e tij, sepse i është hequr liria; dhe mbrojtësi i caktuar kryesisht nga organi procedues.

Mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk është çështje zgjedhjeje. Nëse do të zgjedhësh, shko e zgjidhe mbrojtësin që kërkon, kurse mbrojtësi i caktuar kryesisht, është domosdoshmëria e procesit penal, që nëse e kërkon prezencën e mbrojtësit, autoriteti procedues ka detyrimin t’i caktojë një mbrojtës kryesisht. Momenti i zgjedhjes është çështje vullneti. Nuk mundet që, në një caktim të mbrojtjes kryesisht, të ketë edhe zgjedhje nga lista, nga ana e personit që do të mbrohet. Ai që do të mbrohet ka të drejtë të zgjedhë, kurse caktimin e ka organi procedues. Këto janë terma që funksionojnë kudo, dhe ne nuk kemi pse i miksojmë, duke ngatërruar mbrojtësin e zgjedhur me mbrojtësin e caktuar kryesisht.

Kështu, unë mendoj se rregullimi sipas propozimit të bërë është korrekt.

Vasilika Hysi – Zoti Hoxha, ju mendoni se ky rregullim që ne kemi lënë në pikën 3, po flasim gjithmonë për mbrojtësin kryesisht, që është i caktuar, zgjedhja më e mirë është që ta bëjë prokurori dhe të mos pyetet asnjëherë i pandehuri, të mos ketë ai vullnetin ose të drejtën të shprehë dëshirën?

Artan Hoxha – Në qoftë se do mbrojtës, le të zgjedhë. Nëse do mbrojtës, por nuk ka mundësi, i caktohet kryesisht. Nëse ka raste kur procesi penal kërkon mbrojtjen e detyrueshme, si për shembull: “unë nuk jam i mitur, nuk kam kufizime, kam të drejtë që në procesin penal të prezantohem vetë, nuk dua mbrojtës”. Por, janë disa veprime, janë disa akte, që në procesin penal kërkojnë prezencën e detyrueshme të mbrojtësit. Atëherë ftohet i pandehuri. Pyetja, për shembull. Pyetja personit të arrestuar ose të ndaluar, bëhet gjithmonë – thotë kodi – në prezencën e mbrojtësit. Do një mbrojtës? Ke një mbrojtës të zgjedhur? Jo. Atëherë organi procedues ka ëpr detyrë t’i caktojë mbrojtës, sepse, nëse nuk është prezenca e mbrojtësit, akti që vjen pas këtij veprimi procedural bëhet absolutisht i pavlefshëm.

Tani, po të jetë se i pandehuri këtu do të zgjedhë, atëherë ky është mbrojtësi i tij, nuk është i caktuar nga organi procedues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, s’ka nevojë të zgjedhë ai. Po të zgjedhë, duhet ta marrë vetë mbrojtësin e tij.

Kam edhe diçka, meqenëse ju e nisët, por e latë përgjysëm: Kodi i Procedurës Penale, sepse kam merakun e mos ngatërrohet me Kodin e të Miturve, pra Kodi i Procedurës Penale, kur flet për organ procedues, njih vetëm tre subjekte: në fazën e hetimit paraprak njih prokurorin dhe Policinë Gjyqësore, ndërsa në gjykim gjykatën. Terminologjia që mund të përdoret si organ procedues, kam përshtypjen se është edhe për organet e tjera, siç mund të jenë avokatia, siç mund të jetë ndihma juridike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, organe procedure, Kodi i Procedurës Penale njih tre. Këta marrin provat, këta caktojnë, këta kryejnë veprime, por janë të detyruar t'i kryejnë sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Por, nëse i pandehuri do të zgjedhë mbrojtës, nuk është më i caktuar. Kjo është e vendosur shumë kohë përpara. këto janë edhe modelet e shteteve tjera: ose ka të zgjedhur, ose ka të caktuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, se po xhirojmë bosh të gjithë, për një gjë që është më e thjeshtë se kaq. Zonja Hysi nuk po kërkon që të zgjedhë, por po thotë: a është e mundur të zgjedhë nga lista për mbrojtje, në kushtet kur s'ka mundësi? Ju thatë: jo, nuk ka mundësi.

Ka komente të tjera? Relatori.

Luan Rama – Më sa kuptoj unë, shqetësimi i zonjës Hysi është ky, që në, në listën e personave që përbëjnë listën e avokatëve, që përdoren nga organi i procedurës për mbrojtjen e avokatit kryesisht, të shmanget subjektivizmi i ndonjë prokurori, i cili nga ajo listë zgjedh gjithmonë pjesën më të dyshimtë të listës, *a priori* po them, nëse e kam kuptuar drejt shqetësimin e koleges. Ideja është këtu: nga ajo listë, nëse ka një listë të avokatëve që përdoren për mbrojtje kryesisht, ai të zgjedhë, fjala vjen jo Vasilikën, por Luanin, sepse me Vasilikën prokurori mund të përdorë për të krijuar rrethana subjektive.

Pra, ky është merakun që ka zonja Hysi, e që nuk e thotë për arsye etike, meqë vjen nga fusha e juristëve, ndërsa ne që jemi jashtë juristëve, ndoshta e kemi më të lirë gojën për ta shprehur këtë gjë. Në vlerësimin tim, logjika që parashtron profesori është e drejtë, por ky merak ekziston sepse, nëse lista ka njëzet emra përdoren gjithmonë vetëm pesë avokatë, që përdoren për mbrojtje kryesisht, ndërsa të tjerët lihen jashtë listës, pra janë rrethana subjektive...

Fatmir Xhafaj – A nuk mund ta zgjidhim këtë te ligji përkatës? Është ligji përkatës ai që i rregullon këto marrëdhënie, zonja Hysi, kur të vemi atje. Unë jam dakord.

Artan Hoxha – Cili është rreziku tjetër? Që të tërë do të kërkojnë zotin Rama, sepse është më i miri nga kjo listë. Atëherë, çfarë do të bëhet me listën? Te ligji mund të vihet, që

zonja Hysi e ka merak, rregulli sipas të cilit lista zbret. Po u zgjodh ai, zbret te tjetri, zbret te tjetri më poshtë, e pastaj rikthehet prapë. Pra, mund të jetë një rregullim i teknikës së zgjedhjes atje...

Fatmir Xhafaj – Është te ligji përkatës. Në rregull, në rregull...

Artan Hoxha – ...por jo këtu

Fatmir Xhafaj – Ka këtu një gjë që duhet ta shohim. Atëherë, pse e vazhdojmë diskutimin?

Vexhi Mucmata – Zoti kryetar...

Fatmir Xhafaj – Po.

Vexhi Mucmata – Këtu përcaktojmë rregulla për një proces ligjor të rregullt dhe nuk supozojmë apo vëmë dyshime për prokurorin ose gjykatësin. Mendoj se është një diskutim...

Fatmir Xhafaj – Jo, mund ta shikojmë te ligji. Kur të jemi te ligji i ndihmës juridike, le ta shohim nëse ka vend atje që të vendosim një rregull më të mirë. Në këtë komision do të kalojë, ndaj mbajeni në vëmendje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, patjetër.

Faleminderit!

Keni ndonjë gjë për nenin 36? Dakord.

Neni 37? Dakord.

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Neni 36?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Neni 37.

Dakord.

Neni 38.

Dakord.

Te neni 39 kemi ndryshim titulli.

Dakord.

Neni 40.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te ndryshimi i 58-ës?

Po, zoti Smibert.

John Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Në radhë të parë, dua të them se është e këndshme që Kodi i Procedurës Penale adreson çështjet e viktimave dhe ka përfshirë një nen, i cili i liston të drejtat e viktimave, siç bën 58-a.

Do të sugjerohet të shtoheshin dy gjëra në nenin 58 për ta bërë atë të përputhshëm me direktivën e Bashkimit Europian për të drejtat e viktimave.

E para, është neni 16 i direktivës, që është shtimi i së drejtës për kompensim dhe dëmshpërblim të plotë të viktimës, për të cilën ne kemi sugjeruar tashmë edhe gjuhën përkatëse të formulimit.

Gjuha që ne kemi sugjeruar, përfshin mundësinë që në të ardhmen të krijohen skema të kompensimit të viktimave, nëpërmjet fondeve të kompensimit të viktimave, të cilat janë detyruese në direktivën e Bashkimit Europian.

Shtesa e dytë ka të bëjë me përjashtimin e viktimave në kushte të përcaktuara, kuptohet me ligj, nga pagimi i çdo takse dhe tarife gjyqësore që lidhet me paraqitjen e kërkesave si viktimë e veprës penale.

Kjo kërkesë vjen nga neni 14 i direktivës, i cili kërkon që viktimat të rimbursohen për shpenzimet që bëjnë si viktima ose të përjashtohen, pra të mos kenë detyrimin t'i paguajnë këto shpenzime.

Ne mendojmë se shtimi i këtyre dy elementeve do ta bëjë më të plotë nenin dhe do të na përafrojë me qëllimin e direktivës së Bashkimit Europian.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Smibert!

Ka komente nga ekspertët, nga ministria dhe nga relatorët?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Hoxha – Unë jam mësuar që ta mbështes Xhonin në propozimet e tij. Unë e shoh shumë të arsyeshme propozimin e Xhonit, vetëm se për ne ka qenë e pamundur objektivisht që këto ndryshime që, në fakt, janë ndryshime thelbësore të ish-in pjesë e ndryshimeve që ne kemi paraqitur para komisionit. Kjo edhe për shkak të sistemit që ne kemi.

Ne kemi rregulla të gjyqimit të padisë civile sipas Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile, të cilat vijmë dhe i sjellim në Kodin e Procedurës Penale me padinë civile në procesin penal. Ky është mekanizmi që ne kërkojmë shpërblimin e dëmit për ato dëme që vijnë nga vepra penale.

Propozimi, që bën OPDAT-i dhe zoti Smibert, ka një këndvështrim të ndryshëm që në vetvete është një reformë, e cila kërkon më shumë kohë dhe studim.

Unë mendoj se disa gjëra ne mund t'i rikonsiderojmë në nenin 58, por me një kufizim që na lejon korniza ligjore që ne kemi sot.

Jam shumë dakord me atë që ne ndoshta mund ta themi këtu që, kur shpërblimi i dëmit, kërkohet me padi civile në procesin penal, të mos paguhet sipas rregullave të procesit civil detyrimi i përqindjes që kërkohet në këtë rast për të ngritur padinë civile në gjykatë.

Kjo mund të thuhet në mënyrë të shprehur dhe mund të ketë efekte në procesin civil dhe kur gjykohet veçmas nga procesi penal. Mund të shtojmë edhe elementin, që është propozuar nga OPDAT-i, e kuptimit të viktimës, por që praktikisht është e dhënë, sepse ne kemi një dispozitë, ku themi në fund, në dispozitat kalimtare, se termi “i dëmtuar nga vepra penale”, “i dëmtuar akuzues” zëvendësohen me termin “viktimë” dhe “viktimë akuzuese”, çka do të thotë se automatikisht ne e kemi thënë kuptimin e termit “viktimë”. Por nëse duhet të themi diçka më shumë, jemi të hapur që, në qoftë se komisioni e lejon që këtë dispozitë ta rishikojmë në drejtim të përmirësimit të saj, të gjejmë diçka të mesit në raport me atë që propozohet. Ne jemi dakord që të bëjmë disa modifikime në dispozitë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, t'i marrim me radhë!

Pse nguteni?

Ministria ka ndonjë koment, apo është dakord me komentin e profesor Hoxhës?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Relatorët?

Ulsi Manja – Natyrisht, propozimet e OPDAT-it kanë ardhur me shkrim që para dy ditësh, ekspertët i kanë pasur në dispozicion. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të drejtat e viktimës në procesin penal dhe ne jemi të hapur për këtë dispozitë, pa prekur thelbin e procesit penal, sepse lidhet me sistemin, siç e tha edhe zoti Hoxha, që ne kemi adoptuar në procedurën penale. Por nëse do të jetë nevoja të kemi një përkufizim të viktimës në procesin penal, edhe për këtë është formulimi, pra OPDAT-i e ka propozuar formulimin. Kjo, gjithsesi, ngelet për t'u parë më mbrapa.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam absolutisht dakord me propozimin e zotit Smibert.

Në radhë të parë, ne po bëjmë një revolucion në procesin procedural penal dhe direktiva e vitit 2012 e Bashkimit Europian, si risi në thelbin e saj, nuk ka thjesht të drejtën për informim të viktimës, por është, mbi të gjitha, mbështetja psikologjike, emocionale, juridike, dhënia e gjithë kujdesit për integritet. Por dy janë elementet më të rëndësishme. Pra, thelbi.

Së pari, nuk është ajo që thoni ju, përkufizimi i viktimës, por pikë e parë është neni 16: “Kompensim dhe dëmshpërblim”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Së dyti, është përjashtimi nga taksat.

Unë do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, zoti Hoxha, po edhe të relatorëve, se një nga problemet që ne kemi hasur në praktikën gjyqësore shqiptare, sidomos organizatat që japin mbrojtje dhe mbështetje për viktimat, është që viktima nuk kompensohet asnjëherë ose nuk dëmshpërblehet për faktin se kemi pasur tarifa të larta për të bërë një kërkesëpadi në përqindje. Ka qenë 3%, pastaj u ul 1%.

Së treti, kjo është një çështje që diskutohet prej vitesh në Shqipëri, madje është bërë edhe objekt në Gjykatën Kushtetuese nga një organizatë që jep ndihmë ligjore për viktimat e trafikut. Ju e dini shumë mirë lojën që bëri Gjykata Kushtetuese duke thënë se tarifat janë përcaktuar ose jo në ligj, pra u mor me diçka tjetër që nuk lidhet me thelbin. Por ne kemi edhe një projektligj tashmë në dorë, atë “Për tarifat gjyqësore”, ku është parashikuar mundësia e përjashtimit nga tarifat edhe të kategorisë së viktimave.

Por që të zbatohet ai ligj do të ishte mirë që të zbatohet... Kjo është një e drejtë që viktima duhet ta ketë në procesin penal. Unë mendoj se do të ishte mirë që të parashikohet në nenet 14 dhe 16, por njëkohësisht në direktivë ka edhe disa të drejta të tjera, të cilat nuk i gjej të pasqyruara te neni 58.

Këtu kam një pyetje: pse nuk është marrë direktiva me të drejtat e kësaj... Nuk them në tërësi, se ne nuk jemi të detyruar, por janë disa të drejta të tjera që nuk kërkojnë as kosto, por thjesht një ndryshim mentaliteti.

Për shembull, në rast se personi bën një kallëzim penal, bën ankim, pse të mos ketë të drejtë viktima të marrë një kopje të ankimit që ka denoncuar?

Një nga problemet që na ka rezultuar, është që organi i policisë nuk jep një shkresë ose përmbajtjen e ankimit. Kjo është një kërkesë e direktivës. E themi këtë, sepse shumë herë njerëzit kur thonë: “Kam denoncuar dhe çështja është pushuar”, punonjësi i policisë thotë:

“Nuk kam marrë denoncim prej jush”. Pra, viktimë ka të drejtë të ketë një kopje ose një shkresë që është bërë ky kallëzim në “iks” datë, në “iks” komisariat. Kjo është kërkesë e direktivës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Dakord. Unë besoj se zoti Hoxha ishte i qartë kur tha: ka nevojë për disa elemente të tjera që t’i reflektojmë pa ndryshuar frymën e Kodit të Procedurës Penale. Kështu që besoj se do të mbetet që ta diskutoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po?

Luan Rama – Marr shkas jo thjesht për nenin konkret, por nga diskutimi që bëri zonja Hysi në lidhje me përfshirjen në Kodin e Procedurës Penale të termit “viktimë” në kuptimin ligjor apo ndërkombëtar të fjalës, e cila në kuptimin apo në perceptimin e qytetarëve shqiptarë, por edhe sipas kuptimit që ka fjala “viktimë” në Fjalorin Enciklopedik shqiptar nuk përkon *mot a’ mot* me çdo rast, sepse ka një diferencë në perceptim midis termit “viktimë” dhe “i dëmtuar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kuptoj faktin që ndoshta grupi i punës është kushtëzuar prej direktivës së Bashkimit Europian, por ligji, në rastin konkret Kodi i Procedurës Penale, në vlerësimin tim, nuk mund të mos mbajë parasysh edhe disa detyrime që vijnë nga kodi drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor i gjuhës shqipe, i cili, gjithashtu, është një ligj. Sepse ti i drejtohesh çdo personi të dëmtuar me termin “viktimë”, në shqip tingëllon pak rëndë ose pak keq, për ta thënë. Kështu që mendoj se ndoshta duhet parë edhe mospërfshirja e termit “viktimë” në çdo rast kur bëhet fjalë për të dëmtuarin ose të dëmtuarin akuzues në procesin penal.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Po, zoti Hoxha, për ta përmbyllur.

Besoj se ju thatë që do të reflektoni, do të bëni një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull. Atëherë, le të shohim reflektimin e ndryshimit që do të bëni bashkë me propozuesit.

Faleminderit, zoti Smibert! Faleminderit zotit Hoxha dhe kolegëve!

Vazhdojmë më tutje.

Këshilltarët të mbajnë në vëmendje nenin 40. Besoj se jeni duke e mbajtur shënim.

Moza?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 41.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë kam parasysh nenin 41, i cili shton nenin 58/a “Të drejtat e viktimës së mitur”.

Kuvendi i Shqipërisë sapo ka miratuar ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe në këtë ligj përmendet edhe përfaqësuesi procedural, si person i caktuar nga autoriteti procedues, nga lista e dërguar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor. Njëkohësisht kemi edhe Kodin e Drejtësisë së të Miturve, ku kemi një nen që flet për të drejtat e viktimës së mitur. Kam dy pyetje: në radhë të parë, a mundet që në dy kode të kemi dy nene që flasin për të drejtat e viktimës së mitur, të cilat diku janë më gjerë dhe diku janë më pak të listuara?

E dyta, në paragrafin e parë, në shkronjën “c”, ku ju thoni: “Viktima e mitur ka të drejtë të kërkojë nëpërmjet përfaqësuesit që gjykimi të zhvillohet pa praninë e tij.” Për cilin përfaqësues e keni fjalën, për përfaqësuesin ligjor? Nëse mungon përfaqësuesi ligjor, a mund të jetë përfaqësuesi procedural, të cilit ia njuh të drejtën ligji i sapomiratuar?

Këto janë dy pyetjet e mia.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Hoxha pak shkurt, sepse zonja Hysi e ka parasysh që Kodin e Drejtësisë për të Mitur, do ta shqyrtojmë mbasi të shqyrtojmë këtë kod!

Urdhëroni!

Artan Hoxha - Lidhur me pyetjen e parë, rregullat bazë të procesit penal i përcakton Kodi i Procedurës Penale dhe meqë është edhe ajo që tha zoti kryetar, që ajo që mund të jetë sot përsëritje nëpër projekte, nesër do të evitohet në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Kjo do të thotë që në atë kod ka rregullime, të cilat nuk janë këtu, sepse nëse janë këtu, nuk ka nevojë të përsëriten atje. Kjo është çështje e teknikës legjislative.

Për pyetjen tjetër ne kemi lënë “përfaqësuesit”. E kemi lënë të hapur pa e ditur që ka një rregullim tjetër ligjor, sepse dihet që ka disa mbiemra përfaqësuesish. Kështu siç është, është e hapur për rregullimin e posaçëm ligjor. Meqë ju e thatë këtë, nëse unë kisha ndërmend të bëja një rregullim tani nuk po e bëj dhe po e lë siç është me qëllim që ta lë të hapur për rregullimin e posaçëm ligjor.

Vasilika Hysi – A mund të themi përfaqësuesi ligjor ose...

Artan Hoxha - Nuk e themi dot, se nuk kemi ligj.

Vasilika Hysi – Ligji që përmenda unë ka kaluar, është miratuar në parlament.

Artan Hoxha - Duke e lënë “përfaqësuesit”, i ke të gjithë llojet e përfaqësuesve brenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Meqenëse themi Kodi i Drejtësisë për të Mitur, të drejtat e viktimës së mitur janë një kre më vete, pra shumë më gjerë se ç’është Kodi i Procedurës Penale, që ka vetëm 2-3 nene.

A nuk do të ishte me vend t’i shikonim dhe t’i rakordonim? Të drejtat në Kodin e Procedurës Penale janë shumë më të kufizuara se të drejtat që jep Kodi i Drejtësisë së të Miturve.

Ose të thuhet në këtë nen, që të drejtat e tjera parashikohen te Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

Artan Hoxha - Është thënë gjithandej.

Vasilika Hysi – E kam fjalën në këtë nen.

Artan Hoxha - Nuk ka rëndësi. Kur flitet për subjektin e mitur ka një dispozitë që është më e përgjithshme. Të miturin e kemi sipas fazave të procedimit dhe veprimeve që kryhen. Nuk e grupojmë dot dhe të themi që në Kodin e Procedurës Penale i mituri të ketë një rregullim dhe pastaj t’i referohesh dispozitave të kodit sikur është një qendër. Aty ku duhet i mituri, sipas aktit procedural apo veprimeve që kryhen, ne kemi të miturin si subjekt në atë fazë, në atë moment specifikisht për shkak të karakteristikave të tij me rregullime të posaçme. Te ligji tjetër i madh që ju do të propozoni, në Kodin e të Miturve, aty është vetëm ai dhe nuk ka njeri tjetër.

Unë mendoj që në teknikën legjislative mbeten ato rregullime, sipas hapave që ka procesi penal të pozitës së të miturit në këtë proces.

Për sa i përket merakut në lidhje me referimin, ai rregullim është bërë që ka një referim të posaçëm.

Vasilika Hysi – Unë jam dakord me referimin e bërë te neni 2/2, ku thuhet: “Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në kod”.

Mënyra si fillon neni 58/a, ku thuhet: “Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij kodi, i mituri gëzon dhe të drejta.” Pra, ju thoni se viktima e mitur gëzon të drejtat e nenit 58, plus parashikimeve të tjera të këtij kodi, por nuk e citoni Kodin e Drejtësisë së të Miturve.

Artan Hoxha – Kora thotë që mund ta shtojmë dhe unë nuk jam kundër me Korën.

Nëse e ka dispozita parimore është në rregull, s'ka nevojë për më shumë, por nuk po e kundërshtoj.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet neni 41 me këto ndryshime.

Neni 42. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 43. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 44. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 45. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 46. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 47. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 48. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 49. Jemi dakord. Miratohet.

Ndiqeni të gjithë!

Neni 50. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 51. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 52. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 53. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 54. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 55. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 56. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 57. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 58. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 59. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 60. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 61. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 62. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 63. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 64. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 65. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 66. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 67. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 68. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 69. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 70. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 71. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 72. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 73. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 74. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 75. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 76. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 77.

Vasilika Hysi – Zoti Hoxha, te neni 77, i cili ndryshon nenin 140, kam një pyetje lidhur me paragrafët 3 dhe 4. Ju thoni që kopja e njoftimit nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14 vjeç apo një personi me paaftësi të dukshme intelektuale. Desha të di si mund të përcaktohen paaftësitë e dukshme intelektuale?

Pyetja e dytë: ju thoni në paragrafin 4 se nëse i pandehuri është i mitur, ai njoftohet nëpërmjet prindit apo kujdestarit të tij, si dhe sipas legjislacionit të posaçëm për të miturit. Këtu kam një propozim. Të thuhet: “Sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për të miturit.”

Pra, për paragrafin 3 kam një pyetje, ndërsa për paragrafin 4 kam një ndërhyrje, një riformulim.

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të na thoni për paragrafin 3, se paragrafi u kuptua dhe propozimi është në rregull.

Artan Hoxha – Kësaj pyetje mund t'i përgjigjet Kora.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu ka qenë edhe në rregullimin e mëparshëm të kodit, por kjo është çështje perceptimi.

Fatmir Xhafaj – A keni një shpjegim me konceptet që ka kodi, sepse kjo është pak e diskutueshme si çështje. Ai mund të jetë i paaftë për të vepruar, për shembull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Hoxha – Nuk është tipikisht ashtu.

Koraljka Bumci – Është e riformuluar te amendimet e reja. Është kështu pak a shumë, por kemi bërë një riformulim për çështjen e pamundësive individuale.

Fatmir Xhafaj – Dakord, shiheni paragrafin 3 dhe riformulimin e paragrafit 4 me ndryshimet që propozoi zonja Hysi.

Miratohet neni 77 me këto ndryshime.

Faleminderit!

Artan Hoxha – Nuk e kuptuam pyetjen për paragrafin 3.

Fatmir Xhafaj – Për paaftësitë e dukshme intelektuale.

Artan Hoxha – Kodi në fuqi sot, kështu e ka.

Fatmir Xhafaj – Po të ishte ashtu, e linim edhe këtë.

Artan Hoxha – Këtë nuk e kemi ndryshuar, por meqenëse është teksti.

Fatmir Xhafaj – Pse nuk e keni ndryshuar ju, kjo nuk do të thotë që nuk do ta ndryshojmë.

Artan Hoxha – Varet si do ta ndryshojmë.

Fatmir Xhafaj – Nëse nuk e gjeni ju, atëherë do ta gjejmë ne.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Muçmataj!

Vexhi Muçmataj – Te pika 4 nuk jam dakord me riformulimin që bëri zonja Vasilika. Kur thuhet: “sipas legjislacionit”, nënkuptojmë rregullat dhe nuk ka nevojë të shtohen fjalët “Sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin”. Thënë fjala “legjislacion”, është e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Dakord. Kalon neni 77 me këto ndryshime për t’u riparë.

Faleminderit!

Neni 78. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 79. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 80. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 81. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 82. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 83. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 84. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 85. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 86. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 87. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 88. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 89. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 90.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kishit diçka për nenin 90?

Vasilika Hysi – Te neni 90, që ndryshon nenin 164, shoh një ndryshim të terminologjisë dhe të teknikës zoti Hoxha, lidhur me paragrafin 4 dhe 5, meqenëse po shikoj dhe përputhjen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Ju thoni se parashikimet e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen për dëshmitarët e mitur. Do të doja të theksonim që nga teknika legislative është më mirë të themi që parashikimet e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk zbatohen për dëshmitarin e mitur dhe kjo vlen edhe për paragrafin 4.

E shoh këtë edhe në disa nene të tjera të projektligjit.

Fatmir Xhafaj – Nejse, unë nuk jam ekspert i shkrimit ligjor, por nëse ekspertët thonë që është kështu, dakord. Megjithëse për mua është e kuptueshme se në këtë nen është. Megjithatë, dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vexhi Muçmataj – Me leje?

Unë e shikoj të panevojshëm të shtohet “të këtij neni” për arsye se për këtë nen bëhet fjalë. Kjo është fare e qartë.

Fatmir Xhafaj – Nejse, zonja Hysi ka të drejtë kur thotë, sikur e kanë shkruar dy duar të ndryshme. Po të shohësh 4-ën dhe 5-n janë formuluar në këtë mënyrë, ndërsa te pika 2 thoni: “Gjykata mund të kërkojë vendimin e dhënë sipas paragrafit 1 të këtij neni”. Prandaj mbani një dorë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mjaft tani, se e thamë që të kuptohet dhe të reflektohet! Është gjithë ky volum pune dhe shumë mirë që ne kapim ndonjë gabim që kanë bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, Vexhiu, kolegu yt, nuk u tregua tolerant, se ekspertët janë tolerantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 90 u la të shihet nga pikëpamja e shkrimit ligjor.

Neni 91. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 92, “Dëshmitari anonim”.

Urdhëroni!

Bledar Dervishaj – Faktikisht, kemi pasur diskutime për këtë dispozitë edhe më parë, kur e diskutuam në parim, edhe në vijimësi. Fillimisht, në dakordësi edhe me tryezën që u zhvillua në Këshillin e Ministrave, ne e kemi quajtur të papërshtatshme futjen e këtij koncepti të ri në Kodin e Procedurës Penale, por nga diskutimet që patëm në vijimësi, dakordësua dhe diskutuam që ky mjet i ri procedural që futet në procesin penal do të bënte të cedonim nga parimi i përgjithshëm që dëshmia jepet aktualisht për ato vepra të Kodit Penal, që kanë të bëjnë me krime në fushën e terrorizmit. Aktualisht, kemi propozuar një riformulim të paragrafit të parë: “duke evidentuar veprat penale konkrete”. Unë po citoj vetëm propozimin tonë dhe më pas është në diskutim të Komisionit të Ligjeve, ku dhënia e dëshmisë mund të vendosë dëshmitarin ose anëtarët e familjes...

Fatmir Xhafaj – A mund të bëjmë një gjë? Ta lëmë këtë nen në fund fare?

Bledar Dervishaj – Jo, vetëm doja ta thosha.

Fatmir Xhafaj – Po, mos ki merak!

Jo, të lutem!

Po të mund ta zgjidhnim, do ta zgjidhnim.

Ta lëmë të hapur dhe në fund ...

Ne nuk do ta mbyllim sot.

Po.

Artan Hoxha – Meqenëse e kemi pasur në diskutim, dhe nga veprat me maksimumin 7 vjet, krimi i organizuar dhe terrorizmi, mbetëm te terrorizmi, vijmë te propozimi i parë, që të mos jetë fare si ndryshim në kod.

Fatmir Xhafaj – Të lutem!

Më duhet të mbaj një qëndrim, si në rastin tuaj, ashtu edhe në rastin e zotit Dervishi.

Atij i thashë që të mos e lexojë, atëherë edhe ju, mos e thoni mendimin që keni! Uluni në tavolinë dhe zgjidheni!

Vetëm te kjo fjala “anonim”, kam një kërkesë: nuk gjeni dot ndonjë fjalë tjetër? Kjo ka një ngarkesë, një konotacion jo fort të mirë në gjuhën shqipe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Rama – Zoti kryetar, ju bëtë një propozim racional, që gjithë neni të lihej në fund, që të shohim...

Fatmir Xhafaj – Unë e thashë këtë, jo për të hequr nenin, absolutisht!

Unë e mbështes atë. Pastaj ndryshimin do ta bëni...

Luan Rama – Edhe unë jam dakord me besimin tuaj. Nëse do të jetë “dëshmitar anonim”, “dëshmitar i fshehur”, apo “i mbuluar”...

Artan Hoxha – Dëshmitar që i fshihet identiteti.

Luan Rama – Këtë ta lëmë në fund.

Fatmir Xhafaj – Që i ruhet identiteti, që i fshihet identiteti.

Luan Rama – Kështu që, e lëmë për në fund.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, edhe për ekspertët që kanë punuar, ekspertët e ministrisë, relatorët, si dhe ekspertët ndërkombëtarë, neni 92 mbetet i hapur para votimit në tërësi.

Dakord?

Zoti Dervishi, dakord?

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 93. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 94. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 95. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 96. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 97. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 98. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 99. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 100. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 101. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 102. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 103. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 104. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 105. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 106. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 107. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 108. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 109. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 110. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 111. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 112. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 113. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 114. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 115. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 116. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 117. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 118. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 119. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 120. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 121. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 122. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 123. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 124. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 125. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 126. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 127. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 128. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 129. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 130. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 131. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 132. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 133. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 134. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 135. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 136. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 137. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 138. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 139. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 140. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 141. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 142. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 143. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 144. Jemi dakord. Miratohet.
Neni 145. Jemi dakord.
Te neni 144 apo te neni 145?
Dakord.

Jon Smibert – *(përthën përthyesja)* Përsëri në zbatim të direktivës së Bashkimit Europian për të Drejtat e Viktimave, ne kemi propozuar shtimin e një neni, 279/a, që është e drejta për informim e viktimës, e cila është deklaruar tashmë në dispozitat e përgjithshme. Në këtë nen ne garantojmë detyrimet përkatëse të organeve për të dhënë informim për viktimën në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian.

Neni 6 i direktivës i jep viktimës të drejtën për të marrë informacione të natyrave të ndryshme në lidhje me procedimin. Ky nen parashikon detyrimin përkatës të autoritetit procedues për t’ia dhënë këtë lloj informacioni viktimës.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti Xhon...

Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – Me një riformulim mendojmë se mund të shtohet.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Neni 145. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 146. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 147. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 148. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 149. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Neni 150. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Neni 151. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 152, “Për rifillimin e hetimeve”. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 153. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 154. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 155. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 156. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 157, “ Për dorëzimin e kontrolluar”. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po

Vasilika Hysi – Neni 158. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi -- Neni 159. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po

Vasilika Hysi - Neni 160. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 161. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 162. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 163. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi –Neni 164. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 165. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 166. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Po.

Vasilika Hysi – Neni 167. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 168. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 169. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 170. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 171. Jemi dakord. Miratohet.

Neni 172, “Për vendimin dhe ankimimin, që ndryshon nenin 320”. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 173. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 174, është shtesë pas nenit 321/1 “ Shtrirja e sigurimit të provës”. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 175. Jemi dakord?

Ulsi Manja –Dakord.

Vasilika Hysi – Neni 176. Jemi dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Jon Smibert – (*përkthen përkthyesja*) Na vjen keq, por duhet të rikthehemi edhe një herë mbrapa, ndërmjet nenit 168 dhe nenit 169 të ndryshimeve të propozuara, për propozimin e shtimit të një neni, 312/a, që është praktikisht sjellja edhe një herë në draft e të drejtës së viktimës për të kërkuar marrjen e provave nga prokurori.

Ka qenë pjesë e nenit 58, por me ndryshimet në këtë nen, është hequr dhe duhet të vendoset në një vend tjetër në Kodin e Procedurës Penale. Ne mendojmë se ky është vendi i duhur.

Fatmir Xhafaj – Mbas nenit 143?

Brunilda Jani – Mbas nenit 168.

Neni 312/a. Neni i ri 312/a, që është një nga paragrafët e nenit 58 aktual .

Është ekzistues në kod.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, kur të shkojmë te neni 168...

Brunilda Jani – Po, e kaluam.

Na iku momenti i tij dhe po kthehemi mbrapsh.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zoti Hoxha, dakord?

Artan Hoxha- Po, dakord.

E kam përpara propozimin, i cili thotë se: “Viktima mund të kërkojë marrjen e provave nga prokurori...” (gjë që është edhe në rregullimet tona)“...kur kërkesa nuk pranohet, viktima ka të drejtë të ankohet te gjyqtari i hetimeve paraprake, brenda 5 ditëve nga marrja në dijeni e vendimeve të prokurorit”.

Kjo nuk është teknologjia që kemi ndjekur. Për të gjitha kërkesat që kanë, jo vetëm viktima, por edhe i pandehuri, si dhe palët e tjera në proces, Kodi i Procedurës Penale ka një rregull, që prokurori është i detyruar të marrë, si provat në drejtim të akuzës, ashtu edhe pronat në favor të mbrojtjes. Moskryerja e detyrës është përgjegjësi e prokurorit, por nuk mbetet me kaq.

Në përfundim të hetimeve, ku parashtrihen edhe kërkesat që lidhen me provat, të cilat nuk janë në eventualitet, sepse nuk janë marrë, është gjyqtari i seancës paraprake ai që i disponon.

Gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari që parashikohet në propozimet e 312/a-së të OPDAT-it, nuk është gjyqtar që plotëson hetimin apo urdhëron marrjen e provës, por është një gjyqtar, i cili vendos lidhur me rastet kur kërkohet një vendim gjyqësor, për shembull, për masat e sigurimit, për kontroll banese, apo për përgjimet. Pra, janë ato veprime, të cilat prokurori nuk i bën dot pa autorizim të gjykatës. Nuk ka asnjë funksion tjetër në Kodin tonë të Procedurës, dhe po ia dhamë për viktimën, ne e ndryshojmë komplet konceptin që ka, jo gjyqtari i seancës paraprake, por gjyqtari që gjykon ose vendos për kërkesën gjatë hetimit paraprak. Kështu ne e bëjmë konfuz pozicionin e tij. Nëse do të thoshim për viktimën, atëherë duhet të thoshim për të gjithë. Pra, do të bënim që gjykata në vetvete të ishte pjesë e hetimit, ndërkohë që ajo nuk është pjesë e hetimit.

Të gjitha kërkesat që kanë palët lidhur me provat, përfshirë edhe viktimën, i parashtrijnë në përfundim të hetimit gjyqësor te gjyqtari i seancës paraprake. Kështu që, mendoj se shqetësimi është i rregulluar me të drejtën e viktimës për të kërkuar prova, që është në tërësinë e kodit, sikurse edhe e drejta që të bëjë ankim, po ashtu edhe në kërkimet që bëhen në fund të hetimit paraprak te gjyqtari i seancës paraprake, sepse në fund të ditës atë kërkon ai: nëse është pjesëmarrës ose jo, nëse janë realizuar ose jo të drejtat. Kështu që, nuk është se e përkrahim këtë propozim.

Henriku do të bëjë një...

Fatmir Xhafaj – Po.

Henrik Ligori– Me këtë normativë që ka sot Kodi i Procedurës Penale, në fazën e hetimeve paraprake palët komunikojnë me prokurorin. Pra, intelokutori i palëve në fazën e hetimeve paraprake është prokurori. Si i pandehuri, si i dëmtuari, si viktimia, si palët private, bëjnë kërkesa me prova.

Ka një dispozitë me numër 110, e cila thotë, që palët kanë të drejtë të bëjnë memorie edhe kërkesat e prokurorit. Prokurori është i detyruar t'i përgjigjet me vendim, brenda 15 ditëve.

Për mendimin tonë nuk mund të parashikohet një e drejtë e veçantë për viktimën, e cila nuk i njihet të pandehurit, por nëse prokurori refuzon të marrë provat e kërkuara nga viktimia, po ashtu edhe nga i pandehuri, ekuilibri rivendoset në seancën paraprake.

Nëse argumentet e tyre pranohen nga gjyqtari i seancës paraprake çështja kthehet për plotësimin e hetimeve. Kështu që, besoj se është e zgjidhur kjo gjë në...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zoti Smaibert...

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Ka dy pika për të shtuar këtu: së pari ne nuk mendojmë se viktima është palë në procedimin penal. Nëse viktima është palë në procedimin penal, atëherë kjo nuk është shumë e qartë në draftin e paraqitur;

Ndërkohë që e vlerësojmë shumë paraqitjen e një liste të drejtash për viktimat, siç është bërë në nenin 158. Vlerësojmë që është po aq e rëndësishme që të gjenden vende në kod, ku të sigurohet ushtrimi efektiv i këtyre të drejtave.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Mund ta lëmë të hapur këtë për diskutim. Unë e kuptoj pozicionin tuaj dhe isha i qartë, por gjithsesi meqenëse ka diçka...

Po...

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* Të drejtat e viktimës janë të listuara në nenin 58, por, nëse shikohet neni 58 bashkë me nenin 317, ndoshta mund të garantohet kjo e drejtë duke shtuar edhe viktimën te neni 317 dhe mbase është e mbuluar kjo çështje.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* – Në paragrafin 2 të nenit 317 mund të shtojmë viktimën.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Meqenëse ne e lamë të hapur nenin 58, apo jo Moza, dhe ka një propozim për një shtesë pas nenit 178, unë do t'ju kërkoja mirëkuptimin, që ta ridiskutoni këtë para se ta kalojmë në votimin në tërësi.

Dakord?

Faleminderit!

Besoj se këshilltarët e mbajtën shënim që duhet të shikohen të dyja, neni 58, bashkë me nenin që është lënë.... Këtu me siguri është shtuar diçka, Moza, sepse nga neni 176 kalon te neni 178. Ndoshta me këtë rikonfigurim nenesh do të ...

Vazhdojmë me nenin 178. Dakord.

Neni 179. Dakord.

Neni 180. Dakord.

Neni 181. Dakord.

Neni 182. Dakord.

Neni 183. Dakord.

Neni 184. Dakord.

Neni 185. Dakord.

Neni 186. Dakord.

Neni 187. Dakord.

Neni 188.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Ne jemi dakord me shtimin e seksionit për seancën paraprake, mendojmë se është një mjet shumë i mirë, por kemi diçka për nenin 329, paragrafi i III-të, germa “c”, kur flasim për shprehjen “ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq”. Shqetësimi ynë është se do të krijohet detyrimi për të provuar gjithçka në seancën paraprake dhe për t’i riprovuar edhe një herë të gjitha në gjykimin në themel. Pra, do të kemi një gjyq në miniaturë në seancën paraprake dhe më pas një gjyq të vërtetë në gjykim.

Ne sugjerojmë që në vend të shprehjes “prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën në gjyq” të përdoret shprehja “prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra”.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ligori, urdhëroni!

Henrik Ligori – Çështja mund të diskutohet, por ne kemi një standard për masat e sigurimit. Për të marrë masa sigurimi ndaj personit kërkohet dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova, që ai e ka kryer veprën penale.

Për dërgimin e çështjes në gjyq, sipas kodit që është ende në fuqi, thuhet se, nëse i pandehuri do të dërgohet në gjyq, duhet të ketë prova të plota në mbështetje të akuzës për fajësinë e tij. Ne nuk kemi qenë dakord me këtë, na dukej shumë e ekzagjeruar.

Në seancën paraprake qëndruam në një standard më të lartë se masa e sigurimit, kërkuam të ketë prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën. Gjykohet se me provat që paraqiten nga prokurori në seancën paraprake është e mundur të mbështetet një akuzë në gjyq, ia vlen të bëhet një proces penal, që ndryshon nga standardi për të deklaruar fajtor personin, sepse kemi thënë që të deklarohet fajtor, duhet që akuza të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ai mund të jetë i pafajshëm. Vendoset një diferencë midis tyre.

Megjithatë, nuk kam kundërshtim ta diskutojmë termin, por duhet të bëjmë diferencën e masës së sigurimit me vendimin e fajësisë, të gjejmë diçka në mes.

Fatmir Xhafaj – Dakord, edhe kjo mbetet e hapur para votimit në tërësi.

Henrik Ligori – Mund të diskutohet për të gjetur termin më të përshtatshëm.

Fatmir Xhafaj – Do të thotë se ju do të uleni.

Henrik Ligori – Standardi që propozohet, provat e mjaftueshme për dyshimin e arsyeshëm, më duket shumë i ulët për të dërguar një person në gjyq.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kjo pikë do të sillet e formuluar për t’u riparë. Do t’ju lutesha t’i shikonit bashkë me relatorët!

Dakord me nenin 188.

Neni 189. Dakord.

Neni 190. Dakord.

Unë jam dakord me Xhonin. Për mua, siç e parashtroi...

Megjithatë, ju jeni njerëz të praktikës dhe ndoshta mund të jetë siç thoni ju.

Neni 191. Dakord.

Neni 192. Dakord.

Neni 193. Dakord.

Neni 194. Dakord.

Neni 195. Dakord.

Neni 196. Dakord.

Neni 197. Dakord.

Neni 198. Dakord.

Përfundimisht, ne e zgjidhim çështjen e gjykimit në mungesë, apo jo?

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* – Mendoj se neni “Për gjykimin në mungesë” duhet të lihet i hapur, sepse ka nevojë të riformulohet.

Fatmir Xhafaj – Neni 198, që ndryshon nenin 352?

Dakord.

U bë neni 4, që ngelet i hapur.

Neni 199. Dakord.

Neni 200. Dakord.

Neni 201. Dakord.

Neni 202. Dakord.

Neni 203. Dakord.

Neni 204. Dakord.

Neni 205. Dakord.

Neni 206. Dakord.

Neni 207. Dakord.

Neni 208.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Lidhet me nenin 377. Duke qenë se ka ndryshuar procedura e dërgimit të çështjeve në gjyq, mendojmë se duhet të fshihet si nen. “Veprimtaria e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq ka ndryshuar”, duhet të fshihet si nen.

Fatmir Xhafaj – Pra, propozimi i zotit Smajber është të shfuqizohet neni 377.

Zoti Ligori, doni kohë për ta parë?

Henrik Ligori – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – Ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Artan Hoxha – Jo, nuk jemi tamam dakord. Këtu jemi në gjykim...

Fatmir Xhafaj – Jo, ai tha që duhet vlerësuar. Pra, i jepni kohë vetes që ta shikoni. Nuk po ju them që ta shikoni me nxitim, sepse po thamë dakord, nuk kemi pse t’i kthehemi përsëri. Shikojeni me qetësi dhe na thoni.

Artan Hoxha – Nuk jemi mësuar ne me këto.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, ashtu je mjeshtër ti, po hë.

Artan Hoxha – Sepse mund të jetë në gjykim kjo, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Prandaj ishte propozimi i Dervishit...

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë. Vlerësojeni, sepse edhe nëse ju thoni po në moment, duhet parë se çfarë efektesh ka edhe te dispozitat e tjera. Kështu që, propozimi është që të shtohet një 207\ a pas 207-s, që neni 377 shfuqizohet. Shikojeni dhe na thoni. Dakord? Ky është ndryshimi i pestë që propozohet dhe mbetet i hapur.

Faleminderit!

Neni 208. Dakord.

Neni 209. Dakord.

Neni 210. Dakord.

Neni 211. Dakord.

Neni 212.

(Diskutim në anglisht)

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* - Neni 380.

(Diskutime në anglisht)

Fatmir Xhafaj – Nuk është fare neni 380 këtu.

(Diskutime në anglisht)

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* – Çështja e reflektimit të thënieve të dëshmitarit anonim.

(Diskutim në anglisht)

Fatmir Xhafaj – Ndryshimet tek ai nen, thotë zonja Bumçi, kanë nevojë të reflektohen te neni 380. Kështu që, mbajeni shënim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 211. Dakord.

Neni 212. Dakord.

Neni 213. Dakord

Neni 214. Dakord.

Neni 215. Dakord.

Neni 216. Dakord.

Neni 217. Dakord.

Neni 218. Dakord.

Neni 219.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo pra jo, reflektimi i asaj që kërkon zonja Bumçi është te neni 219.

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* - Te neni 218, pika 3 është...

(Diskutim në anglisht)

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* – Ndjesë, sepse e kam marrë pak me vonesë përkthimin dhe nuk kam bërë reflektimet e duhura.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 219. Dakord.

Neni 220. Dakord.

Neni 221. Dakord.

Zonja Bumçi, jemi shumë të duruar për çfarëdolloj gjëje që do thoni ju, sepse jam shumë në dijeni të faktit se sa keni vuajtur ju me këtë kod. Kështu që, jini e qetë, sepse kam 2 vjet që e shikoj këtë film.

Neni 222. Dakord.

Neni 223. Dakord.

Neni 224. Dakord.

Neni 225. Dakord.

Neni 226. Miratimi i Urdhrit Penal.

Doni ta lini të hapur, sepse prisje një riformulim, tha zoti Muçmata?

Bledar Dervishaj – Ne e kemi sjellë sot në mëngjes.

Fatmir Xhafaj – Po pra, ta lëmë të hapur?

Bledar Dervishaj – Edhe kjo është në grupin e neneve që duhet të lihen për diskutim.

Fatmir Xhafaj – Po pra, neni 226.

Kështu që u bë neni i gjashtë që ngelet i hapur, Moza.

Bledar Dervishaj – ... 406 dhe pas reflektimit të tij edhe 2-3 nenet më poshtë, sepse janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Fatmir Xhafaj – Sigurisht. Jam dakord me ju.

Neni 226.

Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha - Këtu kemi të bëjmë me një ndarje konceptuale.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por ta shikojmë se nuk e kemi parë se çfarë...

Artan Hoxha – Jo, unë e kam parasysh, por në qoftë se është ashtu, ne mund të propozojmë që të hiqet fare, sepse nuk ka kuptim.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Mund ta shikoni ju bashkë me ekspertët, relatorët, zonjën Bumçi dhe zotin Smibert në një minitavolinë këtë nen, në mënyrë që edhe ne ta kemi përpara? Në qoftë se ju thoni që s'jemi fare dakord, ata thonë që ne kemi një version, kurse zoti Muçmata thotë që edhe unë kam një version, atëherë çfarë të bëjmë ne këtu pastaj?

Vexhi Muçmata – Unë mendoj që duhet ta lëmë për riformulim, kryetar.

Fatmir Xhafaj – Zakonisht në të tilla raste unë ndjek këshillën e relatorit. Kijeni parasysh këtë. Me gjithë respektin që kam për ju, unë ndjek gjithmonë këshillën e relatorit dhe relatorët më kanë thënë që janë tre nene që do t'i lënë të hapura, plus dy që i propozoi zoti Smibert bëhen pesë deri tani, në qoftë se unë e kam kujtesën mirë. Këshilltarët prandaj po më ndjekin, që të...

Të gjithë bashkë sa jeni aty keni bërë një punë të jashtëzakonshme. Kini durim edhe për 5-6 nene në mënyrë që t'i qartësoni gjërat, sepse është një gjë shumë e rëndësishme.

Nëse doni t'jua them përsëri që keni bërë një punë të jashtëzakonshme, unë e bëj, por nuk besoj se është ky qëllimi, kur kemi arritur te neni 226.

Dakord.

Faleminderit!

Neni 227.

(Diskutime pa mikrofon)

Është një seksion i gjithë që shtohet.

Për mua është bërë gjë e mirë, sepse shkon edhe me atë që është thënë për ta lehtësuar çështjen e burgjeve, veprat penale të caktuara e të tjera, në mënyrë që në finale të shkojë atje për t'u ndëshkuar ai që ka nevojë për proces ndëshkimi, kurse ai që ka nevojë të gjejë një zgjidhje, që mund të jetë rehabilitim më shpejtë, mund të përfshihet në këto institute të reja që keni futur. Apo jo? Kjo është logjika kam përshtypjen, zoti Ligori. Apo e kam gabim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Neni 227. Dakord.

Neni 228. Dakord.

Neni 229. Dakord.

Neni 230. Dakord.

Neni 231. Dakord.

Neni 232. Dakord.

Neni 233. Dakord.

Neni 234. Dakord.

Neni 235. Dakord.

Neni 236. Dakord.

Neni 237. Dakord.

Neni 238. Dakord.

Neni 239. Dakord.

Neni 240. Dakord.

Neni 241. Dakord.

Neni 242. Dakord.

Neni 243. Dakord.

Neni 244. Dakord.

Neni 245. Dakord.

Neni 246. Dakord.

Vasilika Hysi – Më fal, kryetar!

Zoti Hoxha, ndryshimi që ju bëni te neni 245 bie ndesh me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me përbërjen trupit gjyqësor.

Është e mundur të konfirmojmë nëse do lëmë tre, sepse ne kemi thënë që gjykimet në kolegjet...

Fatmir Xhafaj – A e kemi lënë në orën 17:00 diskutimin për këtë çështje, për Gjykatën e Lartë?

Vasilika Hysi – Mos e kalo atëherë.

Fatmir Xhafaj – Po, ka të drejtë për nenin 245. Kemi lënë një takim në orën 17:00 për ta riparë me Gjykatën e Lartë.

Artan Hoxha – Mundem?

Fatmir Xhafaj – Po.

Artan Hoxha - Çfarëdo që do bisedohet në takimin e orës 17:00...

Fatmir Xhafaj – Do jeni edhe ju zoti...

Artan Hoxha – Që do jem edhe unë.

Fatmir Xhafaj – Po, sigurisht.

Trupi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, që unifikon dhe zhvillon praktikë gjyqësore në kolegji me më pak se pesë gjyqtarë, nuk ka asnjëlloj kuptimi.

Kështu që, në këtë pikëpamje, duke e vënë në Kodin e Procedurës Penale, që është një ligj më lart në hierarkinë ligjore, ne do bëjmë edhe dy propozime për dispozitat tranzitore dhe fundore, ku mund të bëjmë shfuqizime ose ndryshime të legjislativëve të tjera, sepse kemi edhe probleme të tjera, dhe këtu mund të kemi një rregullim, por ajo që nuk është kuptuar në ligjet e tjera, është që Gjykata e Lartë është gjykatë unifikuese, por Gjykatën e Lartë unifikuese me një kolegji me tre gjyqtarë s’ka asnjëlloj arsyetimi dhe logjike. Prandaj, unë propozoj që dispozita të kalojë kështu dhe modifikimet të bëhen ose në dispozitë tranzitore ose në ligjet që tashmë kanë kaluar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, do ta diskutojmë. Edhe neni 246 që ka të bëjë me rekursin ngelet i hapur.

Neni 248, që i bie të jetë 247. Me numërtimin e neneve keni bërë një...

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, dakord.

Neni 249, siç është këtu që do rinumërtohen të gjitha këto. Dakord.

Neni 250. Dakord.

Neni 251. Dakord.

Vasilika Hysi – E lëmë të hapur, zoti kryetar, sepse është pjesë e diskutimit që nisëm në Gjykatën e Lartë.

Fatmir Xhafaj – Po ne sikur definuam për të? Megjithatë dakord.

Neni 252. Dakord.

Neni 253. Dakord.

Neni 254. Dakord.

Neni 255. Dakord.

Neni 256. Dakord.

Neni 257. Dakord.

Neni 258. Dakord.

Neni 259. Dakord.

Neni 260. Dakord.

Neni 261. Dakord.

Neni 262. Dakord.

Neni 263. Dakord.

Neni 264. Dakord.

Neni 265. Dakord.

Neni 266. Dakord.

Neni 267. Dakord.

Neni 268. Dakord.

Neni 269. Dakord.

Neni 270. Dakord.

Neni 271. Dakord.

Neni 272. Dakord.

Neni 273. Dakord.

Neni 274. Dakord.

Neni 275. Dakord.

Neni 276. Dakord.

Neni 277. Dakord.

Neni 278. Dakord.

Neni 279. Dakord.

Neni 280. Dakord.

Neni 281.

Bledar Dervishaj – Neni 281 “Dispozita kalimtare”.

Fatmir Xhafaj – Një minutë, këtu nuk është vetëm kjo, sepse ka edhe një gabim. Pra, duhet të jetë neni 282 dhe nuk është në këtë mënyrë: “Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 korrik”, duhet të jeni neni 283, prandaj duhet riformuluar i gjithë neni 281. Pra, fjalitë janë vendosur...

Bledar Dervishaj – Duhet parë edhe referenca për ligjin për SPAKU-n, sepse ka një ndryshim në pikën 5 te ligji për SPAKU-n, ku thuhet: “Kush ka kompetencën për ndjekjen e kësaj deri në kalimin e këtij afati e të tjera”, duhen parë me vëmendje.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, do ta shohë Bruna e OBDAT-it që ka punuar me të.

Zonja Jani, besoj se nuk thashë ndonjë gjë që nuk shkonte?

Brunilda Jani – Jo, absolutisht.

Fatmir Xhafaj – Ideja qëndron sepse ministria e ngre këtë shqetësim dhe duke qenë se ligjin e SPAKU-t ju e njihni mirë duhet parë dhe të jemi shumë të kujdesshëm te dispozitat tranzitore.

Bledar Dervishaj – Preken edhe dy dispozita që shfuqizohen nga ligji i SPAKU-t aty.

Artan Hoxha – Në legjislacione të veçanta ka disa rregullime që e afektojnë Kodin e Procedurës Penale dhe ne kemi bërë një propozim duke pasur parasysh edhe një propozim që ka OBDAT-i që në ligjin për SPAKU-n, organizmi, funksionimi i institucioneve të luftës kundër korrupsion një afat 300-ditor të shtyhet me 180 ditë. Ne asnjëherë nuk jemi të sigurt që 300-i apo 180-ta mund të jenë të mjaftueshëm...

Fatmir Xhafaj – A mund ta rishikoni këtë?

Artan Hoxha – Ne kemi bërë propozimin...

Fatmir Xhafaj – Ta konfirmojnë ata që janë...

Artan Hoxha - ... që ato hyjnë në fuqi kur krijohen të tjerat ashtu siç funksionon çdo institucion shtetëror.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por shqetësimi i tij është i drejtë. Pra, ka një përplasje dhe të konfirmohet që do të rrijë kështu apo kështu.

Ulsi Manja – Në lidhje me dispozitat tranzitore kemi pasur një diskutim të gjatë në tavolinën e grupit të punës dhe ne si relatorë kemi propozuar që në dispozitën tranzitore ku do

të parashikojmë Kodin e Procedurës Penale t'i rijmë strikt parashikimit të nenit kushtetues 179 pika 8. Pra, të lidhim Kushtetutën me Kodin e Procedurës Penale, sepse ky do të ishte rregullimi më i saktë, pasi Kodi përcakton rregullat e procedurës të procesit penal, kështu që çdo shmangie nga përcaktimi i nenit 179 pika 8 e Kushtetutës nuk na e rregullon dispozitën tranzitore.

Fatmir Xhafaj – Nuk mund të dilni jashtë parashikimit kushtetues.

Ulsi Manja – Dispozita tranzitore që është te ligji i SPAKU-t ka referencë te Kushtetuta, por afatet kushtuese lidhur me kompozimin e institucioneve të reja të drejtësisë, që të gjitha, janë spostuar në kohë, kështu që parashikimi më i saktë do të ishte t'i referohemi Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. E mbyllëm te dispozitat tranzitore, pjesë të cilën e lamë të hapur, pra edhe me të gjitha ato të Gjykatës së Lartë rreth 10 dispozita, të cilat do të trajtohen. Pra, dispozitat e Gjykatës së Lartë do të trajtohen sot pasdite në orën 17:00 në një tryezë në të cilën do të jem edhe unë, ndërsa në lidhje me dispozitën e pjesëve të tjera besoj se zoti Hoxha së bashku me relatorët duhet të lënë një orar, një kohë në këtë moment ose më vonë së bashku me përfaqësuesit e ministrisë, me zonjën Bumçi dhe me zotin Smaiber t'i rishikoni.

Ju e dini, unë nuk mund t'ju imponoj kohën dhe vendin kur ju do të mblidheni.

E mbyllim këtu diskutimin për ta rihapur nesër së bashku me Kodin Penal, në orën 10:00.

Shumë faleminderit të gjithëve për punën dhe durimin e sotëm!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA